

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7172
E enjte, 25 prill 2024
Çmimi 0.50

Fronti European shpall
fitoren me mbi 40 mijë vota
epërsi, Ahmeti: Ky kapitull
u mbyll me sukses | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



SBASHK-U PROTESTON MË 1 MAJ PËR
"QASJEN E KEQE TË QEVERISË KURTI
NDAJ PUNËTORËVE TË ARSIMIT" F. 7

PDK-ja: KORRUPSIONI NË QEVERINË
KURTI, KRYEFJALA E RAPORTIT
TË DASH-it PËR KOSOVËN F. 3

SVEÇLA TAKON DELEGACIONIN ÇEK:
SERBIA VAZHDON TË KETË ASPIRATA
TERRITORIALE NDAJ VENDIT TONË F. 6

EKONOMI



KREDITË E REJA PËR MUJIN MARS
ARRITËN NË 241.20 MILIONË EURO,
DEPOZITAT NË 69.70 MILIONË EURO F. 8

AMBASADORI I FRANCËS VIZITON
"DEVOLLI CORPORATION" F. 8

SPORT



KOSOVËS I BESOHET ORGANIZIMI
I KAMPIONATIT EVROPIAN
TË MUAYTHAIT 2024 F. 12

MACRONI I PËRMEND KURTIT ASOCIACIONIN, FLET PËR RRUGËN E KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS | FAQE 4-5



Presidenti i Francës,
Emmanuel Macron, ka
theksuar rëndësinë e
përparimit të shpejtë dhe të
pakthyesëm nga autoritetet e

Kosovës drejt themelimit të
Asociacionit të Komunave me
Shumicë Serbe në kuadër të
përpjekjeve për anëtarësimin
e saj në Këshillin e Evropës. Ai

i ka bërë këto komente në një
bisedë telefonike me
kryeministrin e Kosovës, Albin
Kurti, njoftoi zyra e
presidencës franceze

FREEDOM HOUSE: QEVERIA E ANGAZHUAR NË FUSHATA KUNDËR GAZETARËVE, ME PËRPJEKJE PËR POLITIZIM TË KPM-së F. 3



UP-ja ZGJEDH DEKANËT E RINJ
DHE SENATORËT F. 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Maqedonia e Veriut voton për presidentin e ri

SHKUP, 24 PRILL - Qytetarët e Maqedonisë së Veriut kanë votuar të mërkurën në raundin e parë të zgjedhjeve për president të ri të vendit. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KShZ) ka bërë me dije për mbarëvajtje të procesit zgjedhor pavarësisht prej disa pengesave të vogla teknike në disa qendra votuese. Qendrat e votimit u hapën në orën 07.00.

KShZ-ja ka treguar se deri në orën 13:00 kanë votuar 26.35 për qind nga 1.8 milion qytetarë me të drejtë vote. Pjesëmarrje më e lartë në votime, prej 42.86-përqindësh, është regjistruar në komunën e Novacit, në jug të Maqedonisë së Veriut, ndërsa më e ulët, prej 10.18-përqindësh, është regjistruar në komunën e Vrapçishtës në rajonin e Gostivarit, në pjesën perëndimore të vendit.

Shifrat kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave nga 3 420 vendvotime nga 3 480 sa janë gjithsej.

Kryetari i KShZ-së, Aleksandar Dashtevski, ka bërë me dije se votimet në përgjithësi po zhvillohen në mënyrë të qetë dhe demokratike, me disa probleme të vogla që nuk ndikojnë në procesin zgjedhor.

Sipas drejtuesve të qendrave të votimit, procesi zgjedhor në përgjithësi është i rregullt pa probleme të natyrave të tjera.

Edhe ministri i Punëve të Brendshme, Pançe Toshkovski, në një prononcim për media tha se deri më tani gjendja e sigurisë është stabile dhe nuk ka asnjë problem sa i përket procesit zgjedhor. "Të gjithë sektorët e policisë janë të pajisur nga ana teknike dhe njerëzore. Ministria e Brendshme po vepron sipas planit dhe po ecën ashtu siç duhet. Mendoj se dita e zgjedhjeve do të kalojë në mënyrë të mirë", tha Toshkovski.



Sipas Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KShZ), të drejtë vote kanë 1.814.317 votues, të cilët duhet të zgjedhin mes shtatë kandidatëve për president të Maqedonisë së Veriut.

Pritjet e qytetarëve nga presidenti i ri i Maqedonisë së Veriut

Qytetarët e Maqedonisë së Veriut, të cilët ekipi i "Radios Evropa e Lirë" i takoi në qendrat e votimit të mërkurën, thanë se cilido prej shtatë kandidatëve që zgjidhet, presin që me autoritetin e tij të ndikojë në zhbllokimin e procesit integruar, në luftimin e korrupsionit dhe ta ndalë hovin e largimit të rinjve nga vendi.

Teksa votuan për ta zgjedhur presidentin e ri të Maqedonisë së Veriut, ata kërkuar rritjen e cilësisë në arsim në mënyrë që gjeneratat e reja me dijen e tyre të kontribuojnë për zhvillimin e vendit.

Velika Minovska, pensioniste nga komuna e Çairit në Shkup, e cila votoi bashkë me bashkëshortin, tha për "Radion Evropa e Lirë" se me rëndësi të veçantë për të është që shteti të ecë para dhe të krijohen kushte për një jetë me dinjitet edhe për më të moshuarit. "Po, votova me shpresë se do të bëhet më mirë. Presim se do të vijmë ditë më të mira. Shpresojmë që vendi të ecë para dhe të ketë perspektivë për qytetarët. Një jetë me dinjitet edhe për ne më të moshuarit", tha Velika Minovska.

Edhe Sunaj Iljazi, rreth të 30-tave, tha se nga zgjedhjet presidenciale pret që Maqedonia e Veriut t'i përshpejtojë hapat drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian duke mundësuar një standard më të mirë për gjeneratat e reja. "Të ketë më shumë punësime për të rinjtë. Të jemi një shtet që i ka institucionet me rregull, të besueshme", tha ai.

Edhe Behar Memishi pohoi se nga presidenti i shtetit pret që me autoritetin e tij të ndikojë në zhbllokimin e procesit të integrimi për Maqedoninë e Veriut: "Presim të zhbllokohet procesi (i integrimi), këtë kërkesë kemi nga ai (presidenti i ri i shtetit)". Ndërkaq Zlatko Ardirovski tha se nga presidenti i ri pret të ndikojë në shtytjen para sa i përket luftës kundër korrupsionit. "Pres që (presidenti i ri) të bëjë më shumë për zgjidhjen e problemit me korrupsionin në nivele të larta, të insistojë në krijimin e kushteve që të rinjtë të mbeten në Maqedoni (të Veriut) përmes ngritjes së cilësisë së arsimit. Kjo është ajo që pres nga presidenti i shtetit, i cili do të zgjidhet", theksoi Zlatko Ardirovski nga komuna Qendër e Shkupit.

Kandidatët për president

Në garë janë presidenti aktual Stevo Pendarovski, i cili është propozuar nga koalicioni për "Ardhmëri Evropiane", që udhëhiqet nga Lidhja Social Demokrate (LSDM). Opozita maqedonase, që udhëhiqet nga VMRO DPMNE-ja, në zgjedhje merr pjesë me Gordana Siljanovska Davkovën, e cila garoi edhe në

regjistruarve në listën zgjedhore, apo gjysmën e votave të mbi 1.8 milion votuesve.

Në raundin e dytë kalojnë dy kandidatët me më së shumti vota, ndërsa fitues zgjidhet kandidati që fiton mbi 50 për qind të votave, me kusht që në zgjedhje të dalë mbi 40 për qind e elektoratit.

Në të gjitha zgjedhjet presidenciale të deritanishme është siguruar censusi prej të paktën 40 për qind.

Fushata elektorale ka zgjatuar 20 ditë dhe është përcjellë me akuza të shumta në mes të kandidatëve.

Rezultatet e para pritet të publikohen pas mbylljes së kutive të votimit në orën 19.00.

Ato, sikurse edhe në ciklet e kaluara zgjedhore, fillimisht do të publikohen nga shtabet e kandidatëve, ndërsa

Fronti European shpall fitoren, Ahmeti: Ky kapitull u mbyll me sukses, me mbi 40 mijë vota epërsi ne shënua

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti në festën e fitores së Frontit European në Tetovë tha se ky kapitull u mbyll me sukses dhe u shpreh se dallimi është mbi 40 mijë.

Ahmeti tha se më shumë e ka gëzuar fitorja në Tetovë, sepse siç tha ai, aty jetpm që 23 vjet.

"Më 8 maj e kam një porosi për të gjithë, si vëllau vëllaut, aty ku rrezikohet ndonjë mandat le të kenë kujdes. Ky kapitull u mbyll me suksesin më të madh, dallimi është mbi 40 mijë, në të gjith komunat fitojmë bindës, por më shumë më ka gëzuar fitorja në Tetovën time, sepse unë që 23 vite jetoj këtu", tha Ahmeti.



zgjedhjet e vitit 2019.

Partitë shqiptare garojnë me dy kandidatët.

Fronti Evropian, nën drejtimin e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), garon me Bujar Osmanin, ministrin aktual të Punëve të Jashtme.

Opozita e bashkuar shqiptare, që përbën koalicionin VLEN, merr pjesë në zgjedhje me Arben Taravarin, kryetarin aktual të komunës së Gostivarit.

Pjesë e garës zgjedhore janë edhe Maksim Dimitrievski, kryetar i komunës së Kumanovës, Stevçe Jakimovski, kryetar i qarkut të Karposhit në Shkup, dhe Biljana Vankovska, kandidate e partisë "E Majta".

Sipas dispozitave ligjore, në raundin e parë është thuar se pamundur të zgjidhet presidenti, pasi një kandidat/e duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të të

KShZ-ja do t'i publikojë më së voni deri nga mesnata e 24 prillit. Po ashtu, kandidatët për president kanë nënshkruar edhe një kod për zgjedhje të drejta dhe demokratike dhe për përmbajtje nga etiketat dhe gjuha e urryjes.

Temat që kanë dominuar fushatën kryesisht kishin të bënin me integrimin evropian, ndryshimin e Kushtetutës për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e saj, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, gjendjen në gjyqësor dhe ndikimin rus në Maqedoninë e Veriut dhe rajon.

Këto zgjedhje njëherësh vlerësohen shumë të rëndësishme për partitë politike, pasi rezultati që do të arrijnë do të jetë test për zgjedhjet parlamentare që do të mbahen më 8 maj, së bashku me raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale.

Ali Ahmeti: Kemi shansin historik ta vulosim njëherë e përgjithmonë orientimin tonë euro-amerikan

Lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, së bashku me bashkëshortin, ka shfrytëzuar të drejtën demokratike të votës për të lënë gjurmë kontributi në trasimin e së ardhmes evropiane. "Me votën tonë kemi shansin historik ta vulosim njëherë e përgjithmonë orientimin tonë

euro-amerikan, t'i themi jo Rusisë, po Evropës! Andaj, ju ftoj të gjithëve që të votoni për fitoren e madhe të kauzës sonë evropiane! Uroj proces të mbarë zgjedhor, në frymë plotësisht demokratike dhe evropiane!", ka thënë Ahmeti pas votimit.



PDK-ja: Korrupsioni në qeverinë Kurti, kryefjala e raportit të DASH-it për Kosovën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 PRILL - Partia Demokratike e Kosovës vlerëson se raporti i fundit i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën shpërfaq paaftësinë dhe dështimin e skajshëm të qeverisë Kurti në të gjitha fushat.

Deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, në një konferencë për medie tha se të gjeturat e këtij raporti faktojnë sesi tash e katër vjet Kosova udhëhiqet nga një qeveri e korruptuar, e paaftë, nepotiste dhe abuzuese e kërcënuese ndaj lirisë së shprehjes dhe asaj të medias. "Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën, i cili edhe këtë herë, sikur vitin e kaluar, është tejet i zymtë, tregon më shumë sesa realitetin tonë në Kosovë. Ky raport, që padyshim është kredibil dhe mirë i analizuar, shpërfaq dështimin e skajshëm të kësaj qeverie në të gjitha fushat, më të rëndësishmet në udhëheqjen e shtetit", shtoi ajo.

Deliu-Kodra ngriti shqetësimin për konstatimin e raportit të DASH-it për korrupsion serioz qeveritar, pjesë e të cilit janë edhe pesë ministra e dy zëvendësministra nën hetime për vepra penale të cilët ndërlihen me korrupsionin. "Kemi edhe dy vendime të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të cilat kanë shpallur fajtoresh ministren e MINT-it, Rozeta



Hajdari dhe zëvendësministren e MPJD-së, Liza Gashi, për mosdeklarim të pasurisë. Rastet eklatante të kësaj qeverie dhe eksponentëve të tyre gjatë këtij mandati që ndërlihen me korrupsionin masiv qeveritar janë tejet të shumta. Aferat e ambasadorit Martin Berishaj, Nagip Krasniqit të KEK-ut, Faruk Mujkës, Ridvan Muharremit dhe ministres Hajdari lidhur me rezervat shtetërore, kontratat njëburimore që tejkalojnë 200 milionë euro, deri te raportimet e fundit të medieve për faljen e miliona borxheve të kompanive nga ministri Liburn Aliu, vetëm sa forcojnë edhe më shumë këto konstatime të DASH-it. Fatkeqësisht, siç e keni parë,

Vetëvendosja në vazhdimësi ka refuzuar kërkesat tona për themelimin e komisioneve hetimore parlamentare duke shtuar dyshimet tona të bazuara se sa thellë ishin zhytur në këto skandale", theksoi ajo.

Deliu-Kodra potencoi se vitet e fundit Kosova ka pësuar rënie në ranglistën për lirinë e medias si pasojë e presionit nga zyrtarë të qeverisë Kurti, të cilët, përveç kërcënimeve e fushatave shpifëse ndaj gazetarëve, kanë ndërmarrë edhe veprime konkrete për të mbyllur një medium nacional. "Kjo pasqyrë nuk i shërben të ardhmes së Kosovës dhe integritetit të saj euroatlantik. Përkundrazi, Qeveria, përmes veprimeve të saj ka përkeqësuar

edhe mirëqenien e qytetarëve edhe imazhin e vendit në botë. Për këto arsye dhe jo vetëm, Kosova tashmë gjendet edhe nën sanksione ndërkombëtare me qindra-miliona euro të bllokuara. Kjo nuk është Kosova për të cilën është punuar me vite", tha Deliu-Kodra.

Ndërkaq anëtari i kryesisë së PDK-së, Përparim Gruda, tha se në Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit përshkruhet me saktësi dobësimi i përgjithshëm i nivelit të sundimit të ligjit, në veçanti ndërhyrjet e qeverisë në sistemin e drejtësisë. "Disa herë në këtë raport gjendet fjalia 'ndërhyrjet politike në drejtësi'. Kjo tregon qartë për përpjekjet e vazhdueshme të kësaj

qeverie për t'i mbrojtur njerëzit e saj të korruptuar përmes ndërhyrjeve në organet e sistemit të drejtësisë. Një gjë kjo të cilën ne si PDK e kemi thënë vazhdimisht, sot është konfirmuar edhe nga raporti i DASH-it. Ndërkohë, nuk është bërë asgjë për t'i realizuar reformat e premtuar në sistemin e drejtësisë, nuk ka filluar ende procesi i vettingut dhe kanë vazhduar shkeljet e Kushtetutës", theksoi ai.

Gruda vuri në pah edhe problemet e shumta që ka Kosova me dhunën kundër grave dhe dhunën në familje, të cilat përmenden në raportin e DASH-it. "Sërisht vihet theksi te dështimet e Qeverisë së Kosovës për ta zbatuar ligjin në mënyrë efektive. Kjo nënkupton edhe dështimin për t'i ndërmarrë masat e nevojshme për të luftuar dhe parandaluar dhunën dhe vrasjen ndaj grave. Po ashtu, kanë munguar edhe programet e integritetit për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore. Nuk mund të mos përmend këtu se pasi një grua u vra dhe u shpall ditë zie, ministrja e Drejtësisë gjeti kohë të shkojë në fushatë për t'u përzier në zgjedhje në Maqedoni të Veriut. Sikur kjo të mos mjaftonte, ajo vazhdoi ekskursionin e saj politik edhe nëpër shtetet e tjera të Evropës, Gjermani dhe Suedi. Kjo tregon mjaftueshëm për seriozitetin e kësaj qeverie për ta trajtuar problemin e vrasjes së grave në Kosovë", tha ai.

Freedom House: Qeveria e angazhuar në fushata kundër gazetarëve, me përpjekje për politizim të KPM-së

PRISHTINË, 24 PRILL - Raporti i Freedom House për lirinë e medias në Kosovë liston një sërë problemesh me të cilat gazetarët dhe mediet janë ballafaquar gjatë vitit 2023 në Kosovë. "Përkundër faktit që Kosova ka një peizazh divers mediatik, duke përfshirë televizione, një kanal publik televiziv, radio stacione, dhe disa portale online, në përgjithësi liria e fjalës dhe shprehjes ka qenë disi e kufizuar, me disa incidente dhe trendë shqetësues në vitin 2023. Shumë medie hezitojnë të përfshihen në mbulim kritik për qeverinë. Gazetarët dhe mediet kanë hasur në disa pengesa, duke përfshirë mungesën e sigurisë në veriun e tensionuar të Kosovës e deri te fushatat denigruese të shpifjes nga qeveria, sulmet nga

bizneset dhe kërcënimet e kohëpaskohshme të medieve sociale", nis raporti në pjesën për medie.

Aty përmenden shifrat e AGK-së për totalin e sulmeve deri në tetor 2023, me 30 prej tyre që kanë ndodhur në veriun e Kosovës, në muajt maj dhe qershor. Raporti përmend emërimin e Luljeta Aliut anëtare të KPM-së, si një përkrahëse e hapur e qeverisë së udhëhequr nga Vetëvendosja. Po për KPM-në në raport përmendet kundërshtimi i shoqërisë civile për Projektligjin e ri të KPM-së që shihet si tendencë për kontrollimin e medieve online.

Sa iu përket fushatave të qeverisë kundër gazetarëve përmenden sulmet e zv/kryeministrit Besnik Bislimi dhe ministrit të



Brendshëm, Xhelal Sveçla, ndaj "Nacionales" dhe Berat Buzhalës pas publikimit të audioincizimeve të shesheve të grupit parlamentar të LV-së, Mimoza Kusari Lila, me zyrtarë të Listës Serbe. Raporti vë në pah përpjekjen e Qeverisë së

Kosovës për ta mbyllur televizionin "Klan Kosova" dhe vendimin e Komerciales kundër përpjekjeve të MINT-it për ta mbyllur atë. "Në qershor 2023, juristja e medias dhe aktivistja Futura Kusari u ballafaqua me

thirrje për dhunë kundër saj online. Ajo fillimisht u veçua nga Rron Gjinoçevi, një përkrahës i madh i Qeverisë së Kosovës, që bëri komente mizogjeniste kundër saj, pasi që ajo e kundërshtoi vendimin e qeverisë për ta revokuar licencën e 'Klan Kosovës' dhe ishte e zëshme për ta kritikuar qeverinë që dështoi të ofrojë masa mbrojtëse për gazetarët që po raportojnë nga veriu", thuhet në raport.

Aty lavdërohet vendimi i shpejtë i Gjykatës për t'i dënua tre sulmuesit e gazetarit Valon Syla. "Gjatë vitit 2023 Kosova vazhdoi t'i strehojë gazetarët nga Ukraina dhe AGK-ja ofroi programe trajnime për gazetarët ukrainas dhe ata afganë", përfundon raporti.

Fillon cikli i trajnimeve për stafin administrativ në UP

Prishtinë, 24 prill - Universiteti i Prishtinës ka filluar ciklin e trajnimeve për stafin administrativ përmes të cilave synohet ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i shkathësisë të profesionistëve administrativë.

Trajnimi i parë është mbajtur nën udhëheqjen e prof. Liridona Jemini-Gashit me tematikën "Stilet e lidërshipt", ku përmes prezantimit dhe sesioneve interaktive, pjesëmarrësit u informuan

mbi stilet e lidërshipt, kulturën organizative si dhe mbi mënyrat për të kontribuar në mënyrë efektive në misionin dhe qëllimet e universitetit. Trajnimet e tilla shërbejnë si

katalizatorë për ndryshime pozitive brenda komunitetit tonë universitar. Duke investuar në stafin tonë administrativ, UP-ja investon në suksesin dhe prosperitetin e ardhshëm të universitetit.





Macroni i përmend Kurtit Asociacionin, flet për rrugën e Kosovës në Këshillin e Evropës

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka theksuar rëndësinë e përparimit të shpejtë dhe të pakthyeshëm nga autoritetet e Kosovës drejt themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në kuadër të përpjekjeve për anëtarësimin e saj në Këshillin e Evropës. Ai i ka bërë këto komente në një bisedë telefonike me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, njoftoi zyra e presidencës franceze

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 24 PRILL - Presidenti francez Emmanuel Macron ka thënë një ditë më parë se Franca i kushton rëndësi përparimit të shpejtë dhe të pakthyeshëm të Kosovës drejt formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në kontekst të rrugës së Kosovës për anëtarësimin në Këshillin e Evropës.

Macroni ka shprehur keqardhje edhe për dështimin e votimeve të 21 prillit në veri të Kosovës, për largim ose jo të kryetarëve, dhe ka bërë thirrje për zgjedhje të reja, me pjesëmarrje të komunitetit serb. Sipas presidencës franceze, ai i ka

bërë këto deklarata në një bisedë telefonike me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, të zhvilluar më 23 prill. “Presidenti e ka mirëpritur zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për Manastirin e Deçanit”, është thënë në një komunikatë për medie të Presidencës franceze. Me kërkesë të Qeverisë së Kosovës drejtuar Agjencisë Kadastrale për transferimin e 24 hektarëve tokë në emër të Manastirit të Deçanit, është përmbushur një nga kushtet kryesore për anëtarësim të Kosovës në Këshill të Evropës - organizatës lidere në fushën e të drejtave të njeriut.

Pronësia e Manastirit të Deçanit mbi 24 hektarë tokë është

konfirmuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës në majin e vitit 2016, por autoritetet përgjegjëse nuk e patën zbatuar vendimin.

Kryeministri Kurti ka thënë se beson që Franca do ta mbështesë anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, pa ndonjë parakusht tjetër. Ai i ka bërë këto komente në “X”.

Më 16 prill Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës e ka mbështetur raportin që rekomandon anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë me seli në Strasburg. Autorja e raportit, Dora Bakoyannis, ka thënë se Kosova i ka plotësuar të gjitha kushtet për anëtarësim dhe çështjen e formimit të Asociacionit e ka konsideruar temë të brendshme të Kosovës.

Çështja tani ka kaluar në duart e ministrave të Jashtëm të Këshillit të Evropës, të cilët duhet të vendosin përfundimisht në maj nëse Kosova do të bëhet anëtarja me re e organizatës.

Disa zëra në qarqet diplomatike kanë thënë se anëtarësimi i

Kosovës mund të mos vendoset fare në agjendën e takimit të ministrave, pikërisht për shkak se disa vende anëtare duan lëvizjen e Kosovës drejt formimit të Asociacionit.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij.

Po më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Serbia kërkon që Kosova t'i zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik.

Gjatë bisedës me Kurtin, Macroni ka kërkuar zgjedhje të reja në katër komunat në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe. “Macroni ka rikujtuar se organizimi i zgjedhjeve të reja, sa më shpejt që është e mundur, është i domosdoshëm, me pjesëmarrje të popullsisë serbe”.

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) ka thënë se iniciativa për

largim ose jo të kryetarëve ka dështuar, pasi në këtë proces kanë votuar 253 prej 46 556 qytetarëve që kanë pasur të drejtë vote.

Për të qenë i suksesshëm procesi, do të duhej të votonin 50 për qind plus 1 votues.

Kjo nënkupton se kryetarët aktualë në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, do t'i vazhdojnë mandatet e tyre.

Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar, e ka bojkotuar procesin e votimit për largim ose jo të kryetarëve shqiptarë në katër komunat veriore, më 21 prill, dhe ua ka kërkuar të njëjtën edhe banorëve serbë.

Kjo parti ka pretenduar se procedurat e planifikuara janë “të pamundura” dhe se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, “ka bërë gjithçka që votimet të dështojnë”.

Iniciativa për largim ose jo të kryetarëve është organizuar, pasi faktori ndërkombëtar ka kërkuar largim të kryetarëve shqiptarë nga pozitat e tyre,

Shumica e vendeve të BE-së, pro heqjes së masave ndaj Kosovës

PRISHTINË, 24 PRILL - Bashkimi Evropian i është afruar heqjes së masave kufizuese ndaj Kosovës, të vendosura para një viti nga Komisioni Evropian si pasojë e përshkallëzimit të situatës së sigurisë në veri të Kosovës.

Masat përfshinin: suspendimin e përkohshëm të grupeve punuese për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, mosftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë dhe suspendimin e vizitave bilaterale.

Gjithashtu, u suspendua edhe programimi i fondeve për Kosovën, të cilat ishin paraparë të dorëzoheshin përmes Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor dhe IPA 2024 (Instrumentet e Para-Anëtarësimit).

Pas masave ndëshkuese, Kosova mbeti jashtë granteve që BE-ja miratoi në korrik të vitit të kaluar në vlerë prej 2.1 miliardë eurosh.

“Radio Evropa e Lirë” nga disa burime diplomatike në BE mëson se shumica e vendeve anëtare janë në favor të heqjes së të gjitha masave, ndërsa një numër më i vogël i shteteve do që heqja e tyre të bëhet në mënyrë graduale.

Kundër heqjes së masave, sipas këtyre burimeve, nuk është shprehur asnjë vend anëtar i BE-së. Kjo përshtypje është vërejtur në diskutimin e fundit që është zhvilluar në BE të martën mbrëma për situatën aktuale në Kosovë. Diskutimi është bërë në Komitetin për Politikë dhe Siguri të BE-së (PSC) ku janë ambasadorët e 27 vendeve anëtare. “Shumica e vendeve anëtare duan të hiqen të gjitha masat ndaj Kosovës, por janë disa vende, në mesin e tyre edhe tri vendet e QUINT-it (Gjermania, Franca dhe Italia) që duan heqjen graduale të masave ndaj Kosovës”, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” një burim diplomatik i BE-së.

Të njëjtat burime kanë thënë se edhe shërbimi i veprimt të jashtëm i BE-së (EEAS) është në favor të heqjes së masave ndaj Kosovës, por hezitim deri tash ka pasur më shumë nga Komisioni Evropian, ku



ndikim të madh ka komisionari për fqinjësi dhe zgjerim, Oliver Varhelyi.

Gjatë diskutimeve të fundit është folur për hapat që ka ndërmarrë Kosova për t'i përmbushur kushtet për heqjen e masave, por edhe për hapat që, sipas raportuesve që kanë folur, nde nuk janë përmbushur në tërësi. Për situatën aktuale në Kosovë para përfaqësuesve të vendeve anëtare kanë folur dy të dërguar të posaçëm të BE-së, Miroslav Lajčak, si i dërguar i posaçëm për dialog dhe Tomas Soryong, i cili është i dërguar i posaçëm për Kosovë dhe shef i zyrës së BE-së në Kosovë.

Ata kanë thënë se situata ende është e tensionuar dhe se problemet e shkaktuara në veri nuk janë tejkaluar as pas mundësisë ofruar serbëve në katër komuna në veri për të votuar për shkarkimin e kryetarëve të këtyre komunave.

Që të dy, sipas burimeve diplomatike, u janë shmangur pyetje direkte se a po e shkel Serbia Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve me Kosovën duke kundërshtuar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e

Evropës. Vetëm kanë konstatuar se Serbia është angazhuar në përpjekje për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës.

Gjatë diskutimit, sipas burimeve diplomatike, ka pasur thirrje që të hiqen të gjitha masat ndaj Kosovës sa më shpejt, sepse ato kanë krijuar përshtypjen se BE-ja nuk ka qasje të balancuar ndaj Serbisë dhe ndaj Kosovës.

Më të zëshmet në kërkesat për heqjen e masave ndaj Kosovës kanë qenë Finlanda, vendet Baltike, Kroacia, Polonia, Sllovenia dhe disa vende të tjera. Ndërsa Franca, Italia dhe Gjermania kanë dashur ta lënë përshtypjen se vendet e QUINT-it kanë qëndrim të përbashkët dhe kanë pëlqyer heqjen graduale të masave. Hungaria, e cila deri vonë ka qenë kundër, tash nuk është shprehur kundër.

Vendet anëtare kanë bërë thirrje që përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtëme dhe siguri, Josep Borrell, sa më parë që të jetë e mundur të raportojë para Këshillit të BE-së për përmbushjen e kushteve nga ana e Kosovës për heqjen e masave. Ky raport është i nevojshëm në mënyrë

që masat të hiqen, në tërësi apo pjesërisht.

Burimet e BE-së kanë thënë se edhe konkluzionet nga takimi i ministrave të BE-së nga 12 dhjetori i vitit 2023 përmendin “heqjen e masave” e jo heqjen graduale siç kërkojnë disa vende. “Këshilli rikujton se BE-ja është e gatshme për heqjen e masave në rast se arrihet progres i mëtijshëm për përmbushjen e kërkesave. Këshilli do ta përcjellë çështjen dhe do t'i kthehet në bazë të raportit të përfaqësuesit të lartë për përmbushjen e këtyre kërkesave”, shkruan në konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së nga dhjetori i vitit të kaluar.

Ka një paqartësi brenda BE-së edhe rreth nevojës që vendet anëtare të pajtohen për heqjen e masave. Kjo, sepse kur ishin vendosur masat, ishte thënë se “kjo është kompetencë e Komisionit Evropian”.

Tash kërkohet që për heqjen e tyre të ketë pajtim nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Burimet e BE-së, pas debatit të fundit, ku u pa gatishmëria e vendeve anëtare, thonë se “BE-ja po afrohet drejt heqjes së masave ndaj Kosovës, porse ende nuk është punë e kryer”.

Pse i janë vendosur Kosovës masa ndëshkuese?

Që pothuajse një vit Kosova ka qenë nën disa masa ndëshkuese nga Bashkimi Evropian. Këto masa ishin vënë pasi BE-ja thoshte se Kosova nuk kishte bërë mjaftueshëm për ta shtensionuar situatën në veriun e banuar me shumicë serbe.

Në maj të vitit 2023 tensionet në atë pjesë të Kosovës kulmuan pas hyrjes së kryetarëve shqiptarë në objektet komunale. Ata dolën nga zgjedhjet që popullsia shumicë serbe në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok i bojkotoi.

Përfaqësues të shteteve perëndimore kanë kërkuar nga Kosova që, përmes zgjedhjeve të parakohshme, të mundësojë largimin e atyre kryetarëve, për të cilët thoshte se nuk përfaqësojnë vullnetin e banorëve. Të dielën Kosova mbajti procesin e votimit që mund të çonte në shkarkimin e kryetarëve të këtyre komunave, por sërish pati bojkot, pas thirrjes që bëri partia më e madhe serbe në Kosovë, Lista Serbe. Pasi që nuk u siguruan votat e mjaftueshme, procesi dështoi. Por, pas mbajtjes së procesit, Qeveria e Kosovës dhe liderë si kryeministri Albin Kurti e presidentja Vjosa Osmani kërkuar që masat ndëshkuese të BE-së të hiqen.

“Radio Evropa e Lirë” e pyeti edhe Qeverinë e Kosovës lidhur me efektet që kanë pasur masat ndëshkuese, por nuk mori përgjigje deri në publikimin e këtij artikulli. As BE-ja s'deshi t'i komentojë efektet specifike të këtyre masave.

duke konsideruar se ndonëse procesi i prillit të vitit të kaluar kur ata i kanë fituar zgjedhjet - ka qenë legjitim, megjithatë, ai nuk e ka reflektuar vullnetin e qytetarëve.

Zgjedhjet e prillit të vitit 2023 janë organizuar pas dorëheqjeve të serbëve nga institucionet e Kosovës.

Edhe në ato zgjedhje, Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, e ka bojkotuar

procesin zgjedhor dhe u ka bërë thirrje serbëve lokalë të veprojnë njëjtë.

Një ditë më parë edhe ambasadori francez në Kombet e Bashkuara, Nicolas de Riviere, ka thënë se në veriun e Kosovës duhet të organizohen shpejt zgjedhje, me pjesëmarrje të të gjitha komuniteteve. “Franca rikujton se tërheqja e kryetarëve të zgjedhur me vetëm 3 për qind të votave do të

ishite mënyra më e shpejtë për rivendosje të demokracisë përfaqësuese në katër komunat në veri dhe do të jetë shenjë e shtensionimit të situatës”, ka thënë ai.

Në komunikatë është përmendur edhe mbështetja e palëkundur e Francës për pavarësinë e Kosovës dhe integritet evropiane të këtij vendi.

Macroni dhe Kurti është thënë

të kenë biseduar edhe për rëndësinë e dialogut Kosovë - Serbi të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian si dhe për zbatimin e plotë të marrëveshjeve të arritura në Bruksel dhe Ohër më 2023.

Dy vendet patën arritur pajtueshmëri për një marrëveshje drejt normalizimit të marrëdhënieve dhe më pas për një aneks zbatimi, mirëpo pak është bërë në atë drejtim.

Edhe vetë Kurti ka insistuar në zbatim të plotë të këtyre marrëveshjeve.

Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar një mori marrëveshjesh prej vitit 2011, kur ka nisur procesi i dialogut, por jo të gjitha janë zbatuar. BE-ja ka përsëritur disa herë se zgjidhja e të gjitha problemeve mes dy vendeve është faktor tejet i rëndësishëm për rrugën e tyre evropiane.

Ambasadori i Britanisë thotë se do ta mbështesin Kosovën në të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë

PRISHTINË, 24 PRILL - Në kuadër të angazhimeve që dalin nga fushëveprimtaria e angazhimeve të tij, Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë, i prirë nga kryetarja Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, priti të mërkurën në takim njohës ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Kryetarja e Komisionit, Kryeziu-Hyseni, ambasadorit Hargreaves i uroi mirëseardhje dhe suksese në

punën e tij të re, ndërkaq vuri në vëmendje marrëdhëniet tradicionalisht të shkëlqyera ndërmjet dy shteteve. Ajo u shpreh e bindur se këto raporte do të fuqizohen edhe më tej, pasi që ato, tha ajo, burojnë nga një miqësi tashmë e dëshmuar dhe e kalitur me dekada. Ngjashëm u shprehën edhe anëtarët e tjerë të komisionit, të cilët u angazhuan që bashkëpunimi i gjertanishëm të avancohet edhe në fusha të

tjera, siç janë: ekonomia, kultura dhe arsimit. Ambasadori Hargreaves, nga ana e tij, pasi falënderoi për pritjen, u shpreh i bindur se marrëdhëniet ndërshtetërore do të vazhdojnë dhe thellohen edhe më tej në një frymë miqësore. Ai, po ashtu, rikonfirmoi se mbështetja ndaj Kosovës do të jetë e sinqertë dhe e pakursyer deri në integrimin e plotë në të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë.



Kurti merr pjesë në Panairin e Bizneseve Hannover Messe 2024

HANNOVER, 23 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar Panairin e Bizneseve Hannover Messe, që këtë vit po zhvillohet me moton "Energizing a Sustainable Industry - World. Leading. Industry Show", ku Qeveria e Kosovës për herë të parë ua mundëson bizneseve nga Kosova pjesëmarrjen aty. Hannover Messe është panairi më i madh ndërkombëtar që mbulon një gamë të gjerë të temave si automatizimi industrial, teknologjia e informacionit, furnizimet industriale, teknologjitë e prodhimit dhe shërbimet, energjia dhe teknologjitë e mobilitetit. Ai njihet si platformë kryesore për transformimin industrial në skenën ndërkombëtare dhe mbahet në Hanover të



Gjermanisë nga data 22 deri më 26 prill 2024. Duke qenë panair me traditë dhe rëndësi, ai u vizitua edhe nga kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz.

Me qëllim të promovimit të kompanive vendore për gjetjen e tregjeve të huaja për eksport të produkteve dhe shërbimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) ka siguruar hapësirën prej 42 m2 për pjesëmarrjen e dhjetë bizneseve në këtë panair.

Kryeministri së bashku me ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ambasadorin e Kosovës në Gjermani, Faruk Ajeti, shefin e stafit të kryeministrit,

Luan Dalipi dhe këshilltaren politike, Fëllanza Podrimja, paraprakisht u mirëpritën nga drejtori ekzekutiv i Deutsche Messe, Jochen Kockler, organizator i panairit.

Në panair delegacioni nga vendi ynë pati mundësi të takojë përfaqësues nga kompani të mëdha e prestigjioze si Microsoft, Siemens, Schneider Electric, e Bosch Rexroth.

Pas pjesëmarrjes në panair, kryeministri Kurti dhe të tjerët zhvilluan një drekë pune të organizuar nga Këshilli i Jashtëm Ekonomik e ku bashkëbiseduan me sipërmarrës të kompanive të ndryshme gjermane. Ai i njoftoi ata me zhvillimin e vendit tonë, ambientin e të bërit biznes dhe mundësitë që ofron vendi ynë për investime.

Deputeti Isak Shabani bashkëbisedoi me nxënës të shkollave fillore "Shaban Shala" dhe "Enver Maloku" të Podujevës

PRISHTINË, 24 PRILL - Forumi për Transparencë Parlamentare, në kuadër të Programit për Edukim Qytetar dhe në bashkëpunim me NDI, mbajti të mërkurën aktivitetin "Ballë për ballë me deputetin" me nxënës të shkollave fillore "Shaban Shala" dhe "Enver Maloku" të Podujevës. Në këtë aktivitet i pranishëm ishte deputeti Isak Shabani, i cili nëpërmjet bashkëbisedimit me nxënës shpalosi punën e institucionit ligjvënës, Kuvendit të Kosovës, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit të nxënësve për ligjet dhe mënyrën e funksionimit të këtij

institucionit. Lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e deputetëve, duke ndarë përvojat e tij si ligjvënës, deputeti Shabani foli rreth funksioneve dhe kompetencave të Kuvendit, punën e komisioneve parlamentare, aspekte të mbikëqyrjes së ligjeve, si dhe rreth rëndësisë së të drejtave dhe lirive të fëmijëve, duke përfshirë të drejtën për arsimim dhe të drejtën për të kultivuar një mjedis të sigurt në mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave dhe lirive të fëmijëve, në funksion të zhvillimit të demokracisë e të shtetit, për të gjithë, pa dallim.

Më tutje pasoi debati me ç'rast nxënësit filloristë patën mundësinë t'i shtronin pyetjet e tyre, duke u interesuar të dinin më shumë rreth angazhimit të deputetit në jetën parlamentare, si dhe për çështje të tjera lidhur me zhvillimet në jetën shoqërore dhe institucionale. Filloristët morën përgjigje nga deputeti Shabani në pyetjet e parashtruara. Nga nxënësit pjesëmarrës takimi me deputetin Shabani u vlerësua si një mundësi e mirë për të kuptuar më mirë funksionimin e sistemit ligjor dhe për t'i zgjeruar njohuritë rreth procesit legjislativ.



Sveçla takon delegacionin çek: Serbia vazhdon të ketë aspirata territoriale ndaj vendit tonë



PRISHTINË, 24 PRILL - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka pritur të mërkurën në takim Tomas Czernin, nënkryetar i Senatit të Parlamentit të Çekisë dhe Pavel Fischer, kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme, Siguri dhe Mbrojtje. Sveçla ka falënderuar Republikën e Çekisë për

mbështetjen e vazhdueshme për Republikën e Kosovës. "Prezantova angazhimet trevjeçare të qeverisë sonë, veçanërisht në fushën e sigurisë publike, luftën ndaj krimit të organizuar, korrupsionit, kontrabandës, trafikëve të ndryshme dhe terrorizmit. Diskutuam për situatën aktuale të sigurisë

dhe për sfidat e vazhdueshme të shkaktuara nga Serbia e cila vazhdon të ketë aspirata territoriale ndaj vendit tonë. E falënderova delegacionin çek për reagimin publik në dënimin e sulmit terrorist të 24 shtatorit dhe zbardhjen e të gjitha rrethanave të këtij sulmi. Z. Fischer në emër të delegacionit të Republikës së

Çekisë falënderoi për mikpritjen dhe përgëzoi për angazhimin e vazhdueshëm që, pavarësisht prej sfidave të njëpasnjëshme, kemi arritur të kemi suksese në prioritetet tona. Të dyja palët shprehëm gatishmërinë e plotë për thellim të bashkëpunimit në fushën e sigurisë", ka thënë Sveçla.

SBASHK-u proteston më 1 maj “për qasjen e keqe të qeverisë Kurti ndaj punëtorëve të arsimit”

PRISHTINË, 24 PRILL - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) përmes një reagimi për medie ka theksuar se qeveria Kurti është duke pasur qasje të keqe ndaj punëtorëve të arsimit. “I nderuar kryeministër Kurti, ministër Murati dhe ti ministere Nagavci para disa viteve kur shkoni në takime ndërkombëtare sindikale dhe bashkëbisedonim me kolegët nga disa shtete të rajonit krenoheshim duke parë se qëndronim mirë me pagat, por edhe me benifitet që sillte Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës. Krenoheshim edhe për takimet dhe dialogun e sinqertë me institucionet qendrore e lokale. Mirëpo në qeverisjen tuaj gjërat ndryshuan dhe ju i nderuari kryeministër, por edhe ministri Murati e ministria Nagavci keni qasje të keqe ndaj punëtorëve të

arsimit dhe kërkesave të tyre legjitime. Tani, si për inat, kolegët nga sindikatat e arsimit të vendeve të rajonit po na lavdërohen me pagat e ngritura vazhdimisht, që dallojnë shumë krahasuar me pagat në Arsimin Parauniversitar të Kosovës. Po na krenohen edhe me Kontratat e tyre Kolektive, për Ligjin për sigurimin shëndetësor, për atë të skemave pensionale dhe për kushtet e punës dhe për respektin e shprehur publikisht të qeverive të tyre ndaj figurës së mësuesit. Ju vepruat krejt ndryshe”, është thënë në reagimin e SBASHK-ut, duke shtuar tutje se “punuat Ligjin për paga që nuk realizoi pritjet e arsyeshme të SBASHK-ut”. “Ju lëvizët në mënyrë ironike vlerën e koeficientit të pagave. Ju nuk e bëtë Ligjin për sigurime shëndetësore. Ju bëtë ndryshime e plotësime në Ligjin



për skemat pensionale dhe, si me qëllim, mohuat të drejtën e fituar nga neni 8, paragrafi 6 që vitet e '90-ta i pranonte arsyeshëm si vite kontributdhënëse. Ju për t'i shuar

sindikatat shkelet Ligjin për organizimin sindikal dhe shlyet tërë anëtarësinë duke i obliguar nëse duan të kenë sindikatë të regjistruar në platformën e

Kosova, që nuk ka ndodhur në asnjë vend të botës. Ju nuk bëtë asgjë as për përmirësimin e kushteve të punës që do të ndikonin shumë në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë. Ju paralizuat punën e Këshillit Ekonomik Social. Ju nuk doni të nënshkruani tani e sa kohë Marrëveshjen Kolektive që garanton të drejtat e punëtorëve në sektorin publik dhe atë privat”, është thënë në këtë reagim. SBASHK-u ka theksuar se si reagim i kësaj qasje të keqe ndaj punëtorëve të arsimit dhe të tjerëve do të ketë protestë më 1 maj. “Prandaj, Qeveri ju bëjmë apel ndryshoni qasjen e keqe ndaj punëtorëve të arsimit dhe të punësuarve tjerë në sektorin publik e privat dhe kështu do të parandaloni veprimet tjera sindikale”, është theksuar në reagimin e SBASHK-ut.

UP-ja zgjedh dekanët e rinj dhe senatorët

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 PRILL - Në Universitetin e Prishtinës është zhvilluar procesi i zgjedhjes së dekanëve të rinj në katërbëdhjetë fakultete të ndryshme të universitetit. Procesi është zhvilluar në mënyrë të rregullt, të qetë dhe ka rezultuar me zgjedhjen e suksesshme të dekanëve. Dekanët e zgjedhur apo rizgjedhur në njësitë përkatëse akademike janë:

1. Fakulteti i Arkitekturës: Prof. Violeta Nushi; 2. Fakulteti i Arteve: Prof. Hazir Haziri; 3. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë: Prof. Arben Musliu; 4. Fakulteti i Edukimit: Prof. Blerim Saqipi; 5. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit: Prof. Florian Miftari; 6. Fakulteti Ekonomik: Prof. Driton Balaj; 7. Fakulteti i Filologjisë: Prof. Abdulla Rexhepi; 8. Fakulteti Filozofik: Prof. Bekim Baliqi; 9. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike: Prof. Isak Shabani; 10. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike: Prof.

Mirlind Bruçi; 11. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit: Prof. Florim Grajçevci; 12. Fakulteti Juridik: Prof. Avni Puka; 13. Fakulteti i Mjekësisë: Prof. Sefedin Muçaj; dhe 14. Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore: Prof. Kajtaz Bllaca. Mandati i dekanëve të rinj fillon më 1 tetor 2024, me fillim të vitit të ri akademik. Në procesin e rregullt zgjedhor, krahas dekanëve, këshillat e fakulteteve kanë zgjedhur edhe anëtarët e rinj të Senatit të Universitetit, që do ta

përfaqësojnë secilën njësi akademike. Anëtarët e rinj të Senatit, me mandat katërvjeçar, sipas fakulteteve, janë: 1. Fakulteti i Arkitekturës: Prof. Florina Jerliu; 2. Fakulteti i Arteve: Prof. Adem Rusinovci; 3. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë: Prof. Imer Haziri; 4. Fakulteti i Edukimit: Prof. Eda Vula; 5. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit: Prof. Bujar Turjaka; 6. Fakulteti Ekonomik: Prof. Liridon Veliu; 7. Fakulteti i Filologjisë: Prof. Shpetim Elezi; 8. Fakulteti Filozofik: Prof. Sejdi Rexhepi; 9.

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike: Prof. Valdete Rexhebeqaj-Hamiti; 10. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike: Prof. Rexhep Selimaj; 11. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit: Prof. Figene Ahmed; 12. Fakulteti Juridik: Prof. Iliriana Islami; 13. Fakulteti i Mjekësisë: Prof. Kreshnike Dedushi-Hoti; dhe 14. Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore: Prof. Fisnik Aliaj. Edhe mandati i senatorëve të rinj fillon më 1 tetor 2024, në fillim të vitit të ri akademik.

Nagip Krasniqi shkarkohet nga pozita e kryeshefit të KEK-ut

PRISHTINË, 24 PRILL - Bordi i Drejtorëve të Korporatës Energetike të Kosovës, përmes një njoftimi për medie, ka bërë me dije se ka liruar nga detyra e kryeshefit ekzekutiv, Nagip Krasniqin. “Bordi i Drejtorëve (BD) të KEK sh.a. duke qenë i përkushtuar për qeverisjen e korporatës në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat që rrjedhin nga Ligji për

Ndërmarrjet Publike, si dhe parimet e njohura ndërkombëtare për qeverisjen korporative të” ndërmarrjeve publike, në mbledhjen e mbajtur dje me datë: 23.04.2024 ka marrë dy vendime të rëndësishme të cilat kontribuojnë në menaxhimin korporatës. Bordi i Drejtorëve të KEK sh.a. ka marrë vendim për të liruar nga

detyra tashmë ish-kryeshefin ekzekutiv, z. Nagip Krasniqi. Bordi i Drejtorëve të KEK sh.a. po ashtu ka vendosur që në ditët në vijim të inicohen e procedurat për shpalljen publike (konkursin) për pozitën e kryeshefit Ekzekutiv të ri të Korporatës Energetike të Kosovës”, është bërë me dije në njoftimin e Korporatës energetike të Kosovës.



Kreditë e reja për muajin mars arritën në 241.20 milionë euro, depozitat në 69.70 milionë euro

PRISHTINË, 24 PRILL - Shtatë miliardë e 500 milionë euro janë asetet e bankave komerciale në Republikën e Kosovës derisa shuma e depozitave të qytetarëve arrin në 6.05 miliardë euro. Kështu thuhet në statistikat e bankave komerciale për muajin mars 2024, të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK),

duke shtuar se vlera e kredive bruto ka arritur në 5.09 miliardë euro me një rritje prej 132 milionë eurosh. Sipas raportit, kapitali i bankave komerciale për këtë muaj ishte 868.56 milionë euro.

Më tutje, BQK-ja tregon se vlera e kredive të reja ishte 241.20 milionë euro, ndërsa shuma e depozitave të reja

arriti në 69.70 milionë euro. Po ashtu, norma mesatare e interesit në depozita ishte 2.71 %, ndërsa norma mesatare e interesit në kredi ishte 6.24 %, ku në muajin paraprak ka qenë 6.34 %.

Raporti kredi-depozita për këtë muaj ishte në nivelin 84.70 %, kurse margjina e normës së interesit në kredi dhe depozita ishte 3.53 %.



Ambasadori i Francës viziton "Devolli Corporation"

PRISHTINË, 24 PRILL - Ambasadori i Francës në Prishtinë, Olivier Guerot, është përfaqësuesi i radhës i korit diplomatik të akredituar në Kosovë, i cili ka vizituar ambientet e njëres prej korporatave më të mëdha në rajon, "Devolli Corporation".

I pritur nga aksionari Shkëlqim Devolli dhe anëtarë i bordit, Adriatik Kelmendi, diplomati ka qëndruar në hapësirat e fabrikës "Comodita" në Gjakovë, si dhe "M&Silloi" në Xerxë.

Ambasadorit francez i është treguar në praktikë i gjithë procesi prodhues që ndodh në këto dy fabrika, të cilat janë më të mëdhatë në rajon me kapacitetet e veta, kurse është diskutuar edhe për nivelin e bashkëpunimit të njësive të "Devolli Corporation" me kompanitë evropiane, veçanërisht ato nga Franca.

"Duke parë nga afër se çfarë potenciali kanë këto dy fabrika, që



nga Kosova bashkëpunojnë me botën, do të dëshiroja që edhe bashkëpunimi me kompanitë franceze të ishte shumë më i madh se që është momentalisht", është shprehur diplomati Guerot.

Aksionari Devolli ka treguar se cili ka qenë rrugëtimi i deritashëm i "Devolli Corporation" si dhe për planet për të ardhmen. "Ne dëshirojmë që ta ndryshojmë mënyrën se si shihet Kosova nga jashtë. Nga një vend që ka dalë nga lufta, tash të njihet si një vend prej nga vijnë prodhime cilësore, konkurrenca me tregjet evropiane", ka theksuar Devolli.

Edhe ambasadori francez edhe sipërmarrësi i Kosovës janë pajtuar se duke pasur thellim të bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar të kompanive nga Kosova dhe atyre nga Franca, do të fitonte në peshë edhe marrëdhënia e përgjithshme ndërmjet dy vendeve.

Dhoma e Tregtisë dhe komuna e Hanit të Elezit nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi për bizneset në fusha të ndryshme

PRISHTINË, 24 PRILL - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë dhe Komuna e Hanit të Elezit kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi përmes të cilit palët janë pajtuar të krijojnë partneritet me qëllim të shkëmbimit dhe ofrimit të këshillave profesionale për bizneset në fusha të ndryshme, si dhe të asistimit, promovimit e përkrahjes së komunitetit të biznesit.

Thellimi i bashkëpunimit, ofrimi i këshillave profesionale nga sektorë të ndryshëm për bizneset anëtare në Dhomën e Tregtisë, këmbimi i informacioneve nga

bazat e veta të të dhënave lidhur me aktivitetet e tyre dhe të bizneseve anëtare si dhe përgatitja e propozimeve dhe realizimi i projekteve të përbashkëta që kanë të bëjnë me përkrahjen e komunitetit biznesor në Kosovë, përfshijnë disa prej pikave që përmban memorandumit i bashkëpunimit i nënshkruar ndërmjet Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë me komunën e Hani të Elezit.

Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, Skënder Krasniqi, ka theksuar se DhTIK-ja është e gatshme të bashkëpunojë



me të gjitha komunat, posaçërisht në iniciativa lokale me qëllim që

komuniteti i biznesit të përfitojë, barrierat në punën e tyre të

minimizohen dhe të krijohet ambient më i përshtatshëm për të investuar në Kosovë.

Ndërsa kryetari i komunës së Hanit të Elezit, Mehmet Ballazhi, ka theksuar se angazhimi dhe gatishmëria e komunës qëndron në nivel të lartë për krijimin e një klime sa më të favorshme për komunitetin e biznesit.

Ballazhi, po ashtu, potencoi faktin se sektori privat ka nevojë për më shumë përkrahje. Në kuadër të këtij takimi u theksuan edhe mundësitë e bashkëpunimit përmes projekteve të Bashkimit Evropian.

Hoti: Elbert Krasniqi duhet të përgjigjet përse i shpenzoi 3 milionë euro me kontrata njëburimore

Prishtinë, 24 prill - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se ministri i Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, duhet të përgjigjet përse i ka shpenzuar 3 milionë euro me kontrata njëburimore për ndërtimin e shtëpive për

komunitete, siç kanë gjetur organizatat joqeveritare.

"Sa për grantet e pushtetit lokal, Kosova ka qenë shembull për pushtetet lokale në rajon dhe më gjerë për objektivitetin e ndarjes së granteve nga pushteti qendror tek ai lokal.

Bashkëpunimi i qeverisë me pushtetin lokal kurrë nuk ka qenë më i keq. Ky ministër ka përgjegjësi që për dy vite me radhë janë vonuar të hyrat vetjake për komunat dhe i kanë bllokuar investimet kapitale nëpër komuna", ka shkruar Hoti në "Facebook".



“Një autograf për nipin tim – skllavin tuaj”!



John Steinbeck (1902–1968) – fitues i çmimit Nobel për Letërsi më 1962 – në vitin 1952 botoi veprën Në lindje të Edenit [East of Eden]. Libri pati sukses të madh dhe shpejt u bë bestseller dhe film më 1955. Steinbeck ishte shkrimtar i njohur, me shumë miq të famshëm – përfshirë disa yje të Holivudit. Një ditë mëson se Marilyn Monroe ishte një nga adhurueset e librit të sipërpërmendur. Thuhet se Marilyn ia kishte kërkuar një kopje të nënshkruar. Letra e mëposhtme ka disa vjet që qarkullon në internet dhe fillimisht nuk dihej nëse ishte përbushur ose jo kërkesa e tij për një autograf për nipin. Letra doli në ankand më 2016. Nipi Jon ka thënë se nuk e ka pranuar fotografinë dhe se nënshkrimi i Steinbeckut ishte i falsifikuar. Po ashtu, shton se letrat i shkruante me laps e jo me makinë shkrimi. Pos kësaj, edhe analizat e nënshkrimit në fund të letrës

bëjnë me dije për mashtrim. Megjithatë, letra ka marrë famë dhe interpretohet si mënyra më e mirë për të kërkuar diçka – një favor nga dikush tjetër me mundësitë për t'ia dalë mbanë. Letra e përfolur është si më poshtë:

E dashur Marilyn:

Në gjithë përvojën time s'e kam njohur kurrë dikën që kërkon autograf për veten. Autografi është gjithmonë për fëmijën ose një hallë të moshuar e cila bëhet shumë e mërzitshme, siç e dini këtë më mirë se unë. Prandaj, nuk më vjen mirë kur them se kam një nip që jeton në Ostin të Teksasit, emri i të cilit është Jon Atkinson. Posa ka hyrë në pubertet, por ky është vetëm një nga problemet e tij. Ju jeni tjetri. E di se nuk jeni e krijuar nga eteri qiellor, por këtë ai s'e di. Do ta trondiste thellë sugjerimi se keni funksione normale, ndërsa unë nuk do të jem ai i cili këtë do t'ia

thoshte atij.

Gjatë udhëtimit të fundit në Teksas, gruaja ime e bëri gabimin fatal duke i treguar Jonit se ju kisha takuar. Në të vërtetë, ai këtë nuk e beson, por respekti i tij ndaj meje është i madh madje edhe nëse për këtë e gënjej. Tani më kërkohen disa favore të pakuptimta, kështu që nuk e kam asnjë hezitim që ta kërkoj një të tillë prej jush. A do t'i dërgonit atij, nën përgjegjësinë time, një fotografi tuajën, ndoshta në gjendjen shpirtërore të një vajze të zhytur në mendime, të cilën ia kushtoni atij me emër dhe ku bëni me dije jeni në dijëni të ekzistencës së tij. Ai tashmë është skllavi juaj. Kjo do ta bënte timin. Nëse këtë e bëni, do t'jua dërgoj çelësin e hyrjeje së zonjave në dhomat e zemrave të mbyllura dhe, mbi të gjitha, do t'ju pëlqejë edhe më shumë.

Sinqerisht
John Steinbeck

/Telegrafi/

April 28, 1955

Miss Marilyn Monroe
Waldorf Towers
Room 2728
New York City, N. Y.

Dear Marilyn:

In my whole experience I have never known anyone to ask for an autograph for himself. It is always for a child or an ancient aunt, which gets very tiresome, as you know better than I. It is therefore, with a certain nausea that I tell you that I have a nephew-in-law who lives in Austin, Texas, whose name is Jon Atkinson. He has his foot in the door of puberty, but that is only one of his problems. You are the other.

I know that you are not made of celestial ether, but he doesn't. A suggestion that you have normal functions would shock him deeply and I'm not going to be the one to tell him.

On a recent trip to Texas, my wife made the fatal error of telling Jon that I had met you. He doesn't really believe it, but his respect for me has gone up even for lying about it.


Now, I get asked for all kinds of silly favors, so I have no hesitation in asking one of you. Would you send him, in my care, a picture of yourself, perhaps in pensive, girlish mood, inscribed to him by name and indicating that you are aware of his existence. He is already your slave. This would make him mine.

If you will do this, I will send you a guest key to the ladies' entrance of Fort Knox and, furthermore, I will like you very much.

Yours sincerely

John Steinbeck

js:mf



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosovës i besohet organizimi i Kampionatit Evropian të Muaythait 2024

PRISHTINË, 24 PRILL - Kosova do të jetë mikpritëse e një tjetër ngjarjeje madhështore gjatë këtij viti. Është Federata e Muaythait e Kosovës (FMTHK), së cilës i është besuar organizimi i Kampionatit Evropian, i cili do të mbahet prej 7-14 nëntor në Prishtinë. Përmes

një letër konfirmimi Federata Botërore e Muaythait (IFMA) i ka konfirmuar FMTHK-së dhënien e organizimit të Kampionatit, pas vizitës së bërë javë më parë të drejtuesve të kësaj Federate në Kosovë. "Vendimi për t'i dhënë të drejtën e organizimit FMAK-së është

marrë pas shqyrtimit të kujdesshëm të faktorëve të ndryshëm, duke përfshirë përkushtimin e demonstruar të Federatës për zhvillimin dhe promovimin e muaythait, si dhe objektet dhe infrastrukturën mbresëlënëse që Kosova ka në dispozicion. Ne kemi

besim se nën udhëheqjen tuaj, Kampionati Evropian 2024 do të jetë një sukses i jashtëzakonshëm, duke shfaqur talentin e muaythait nga e gjithë Evropa", thuhet në letërën e drejtorit gjeneral të IFMA-së, Charissa Tynan. IFMA ka 50 anëtarë të Evropës, që nënkupton se në



Evropianin në Prishtinë pritet të jenë rreth 500 garues të 50 shteteve të kontinentit tonë.

Ballkani dhe Prishtina kualifikohen në finale të Kupës

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 PRILL - Ballkani dhe Prishtina janë dy skuadrat që kanë siguruar kualifikimin në finale të Kupës së Kosovës në futboll, pasi kanë dalë më të suksesshme se Suhareka, përkatësisht Drita në gjysmëfinale të kësaj gare mjaftë prestigjioze në futbollin kosovar. Skuadra e Ballkanit luajti baras me Suharekën në ndeshjen kthyesë të gjysmëfinalës së Kupës (2-2), por e ka siguruar kualifikimin në finalen e madhe, pasi e kishte fituar ndeshjen e parë me rezultat 0-1. Në minutën e 10-të, Gëntrit Halili e kaloi skuadrën e Ballkanit në epërsi. Me rezultat 1-0 përfundoi pjesa e parë, derisa në pjesën e dytë Nazmi Gripshi realizoi për 2-0. Suharekasi që janë pjesë e Ligës së Parë e realizuan golin e parë nëpërmjet Susurit, tetë minuta para fundit. Ndërsa me anë të Susurit në fund të ndeshjes arritën

të barazojnë rezultatin 2-2, por kjo ishte e tera që e arriti në këtë ndeshje dhe Ballkani i Ilir Dajës do të luajë në finale. Në finale është kualifikuar edhe skuadra e madhe vendore, Prishtina. Kryeqytetasit janë finalist i dytë në garën e Kupës në futboll, pasi e mposhti në ndeshjen kthyesë Dritën në Gjilan (0-1). Pjesa e parë e ndeshjes përfundoi 0-0, sikurse edhe e dyta. Në vazhdimë, Prishtina doli te jetë skuadër më e mirë, pasi kaloi në epërsi me autogolin e Albert Dabiqajt, në minutën 111-të. Në ndeshjen e parë të zhvilluar në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan, ndeshja kishte përfunduar 0-0. Siç dihet skuadra fituese e Kupës siguron pjesëmarrjen në garat evropiane. Ballkani është lider dhe në garë për titull dhe ka mundësinë të dalë në Evropë edhe nëpërmjet kampionatit, derisa Prishtina ka humbur gjasat për titull dhe objektivin e vetëm e ka triumfin në Kupë.



Java e Kupës së Kosovës, spektakli në 'Karagaçi'



Pejë, 24 prill - Skuadrat më të mira të hendbollit në vend e kanë kthyer gjithë fokusin te turneu final i Kupës së Republikës së Kosovës. Turneu final i Kupës, përkatësisht ndeshjet gjysmëfinale dhe finale, është vendosur të luhen në palestrën "Karagaçi" në Pejë. E shtuna dhe e diela do të jenë të mbushura me ndeshje të forta e cilësore të hendbollit. Tashmë është caktuar edhe orari i ndeshjeve. Fillimisht të shtunën në program

janë dy gjysmëfinalët te hendbollistët. Nga ora 14:00 takohen Vushtrria e Istogu. Istogu është fitues në fuqi i Kupës dhe llogaritet favorit. Prej orës 16:00 është ndeshja Ferizaj - Samadrexha. Të dyja skuadrat kanë pretendime të mëdha dhe pritet ndeshje dramatike. Më pas janë ndeshjet gjysmëfinale te hendbollistët. Fillimisht prej orës 18:00 takohen Trepça e Kastrioti. Trepça është fituese në fuqi e Kupës, por Kastrioti e synon

finalen e madhe. Pritet ndeshje, po ashtu, interesante. Ndeshja kryesore e ditës zhvillohet prej orës 20:00. Takohen Rahoveci e Besa Farnas. Këto dy skuadra kanë luajtur katër ndeshje shumë të forta në stinorin e rregullt. Të gjitha ndeshjet janë vendosur në aksionet e fundit. Njëjtë pritet të jetë edhe të shtunën mbrëma në "Karagaçin" e Pejës. Shpresohet në numër të madh shikuesish që spektakli i Kupës të jetë i kompletuar.

Tomas Danilevicius përfundoi vizitën në FFK, i jep mbështetje projektit TDS

PRISHTINË, 24 PRILL - Tomas Danilevicius, ish-presidenti i Federatës së Lituaniës, i cili tani shërben si konsulent teknik rajonal i FIFA-s, ishte në Kosovë për tri ditë për ta mbështetur projektin TDS. Ky projekt u

zbatua nga Federata e Futbollit e Kosovës dhe është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e talenteve vajza në futboll. "Ky projekt ka përfshirë aktivitete stërvitore çdo javë në Kampin Nacional në Hajvali, si dhe

ligjërata për një stil jetese të shëndetshëm për vajzat pjesëmarrëse. Pjesë e projektit TDS është edhe liga U13 dhe U15, e cila sivjet ka filluar si projektpilot", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Tomas Danilevicius shprehu përgëzimet e tij për punën e mirë që po bëhet nga stafi i FFK-së për realizimin e projekteve që ndihmojnë në gjithëpërfshirje dhe zhvillimin e futbollit për vajzat.



Kosova merr pjesë me pesë xhudistë në Kampionatin Evropian

Zagreb, 24 prill - Nga data 25 deri më 27 prill 2024 do të mbahet Kampionati Evropian i Xhudos për Seniorë në Zagreb të Kroacisë. Kosova do të marrë

pjesë me gjashtë xhudistë në këtë garë. Distria dhe Flaka ndeshen ditën e parë, kurse ditën e dytë ndeshen Akili dhe Dardani, Loriana ndeshet ditën e tretë. Në

këtë kampionat marrin pjesë 47 shtete, me 427 garues, 240 meshkuj dhe 187 femra. Ekipi i Kosovës udhëhiqet nga trajneri dhe selektori Driton Kuka dhe Majlinda


Kelmendi. Nga Kosova do të garojnë: Distria Krasniqi (-52 kg), Flaka Loxha (-57 kg), Akil Gjakova (-73 kg), Dardan Cena (-73 kg), Loriana Kuka (-78 kg).



Arteta: Kënaqësi të shohësh këtë Arsenal duke luajtur futboll

LONDËR, 24 PRILL - Arsenali ka marrë sërish kreun e Premierë Ligës, duke kryesuar me tri pikë më shumë se Liverpooli dhe katër më shumë se Manchester City. Londinezët shpartalluan 5-0 Chelsea në derbi, në një ndeshje të përkryer, duke kaluar kuotën e 100 golave këtë sezon në të gjitha veprimtaritë.

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, i kënaqur nga paraqitja dhe rezultati: "Jam i kënaqur me fitoren dhe numrin e rasteve e golave që shënuam. Gjithashtu, fitorja kaq e thellë dhe pa pësuar gol tregon qëndrueshmërinë e kësaj skuadre. Duhet të ishim më të disiplinuar në pjesën e dytë për t'i bërë gjërat e duhura dhe krijuam shumë raste dhe e mbrojtëm zonën tonë shumë më mirë. I përgëzoja lojtarët që i bënë të lumtur tifozët tanë në një derbi të madh të Londrës dhe ishte një gëzim t'i shikojta ata duke luajtur". "Tani është radha e Tottenhamit. Lojtarët e mi e dinë se për çfarë po luajmë. Ata janë



shumë të emocionuar dhe janë gati në këtë sfidë. Edhe lojtarët që nuk kanë luajtur shumë kanë qenë të jashtëzakonshëm dhe kjo e mban ekipin të bashkuar", u shpreh trajneri spanjoll. "Detyra ime është të vazhdoj të sfidoj dhe

të jem kërkues ndaj tyre. Por, gjithashtu, dua t'i bëj të besojnë se mund ta bëjnë realitet këtë ëndërr, ta fitojnë titullin, sepse kjo është një gjë shumë e rëndësishme", ka deklaruar Arteta.

Dallasi dhe Indiana barazojnë serinë e çerekfinaleve, Minnesota leksion Phoenixit

MINNESOTA, 24 PRILL - Minnesota udhëheq 2-0 serinë e ndeshjeve çerekfinale "play-off" në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 105-93 ndaj Phoenixit. Sfidë e komanduar nga vendasit, ku të gjithë titullarët realizuan mbi 12 pikë. Dallimin e bëri McDaniels me 25 pikë, ndërsa 20 pikët e Bookerit për Phoenixin mbetën për statistikë. Po në Perëndim, ekipi i Dallasis fitoi me shifrat 96-93 në fushën e clippersave, duke barazuar 1-1



serinë e takimeve çerekfinale. Një ndeshje magjike për Luka Donqin, protagonist në fushë me 32 pikë, mbështetur edhe nga Irvingu me 23 pikë. Në kahun tjetër, Harden e George realizuan nga 22 pikë secili, por që s'mjaftuan. Në Konferencën e Lindjes, barazim 1-1 me ndeshje

edhe mes Milwaukee e Indianas, me miqtë që fituan me rezultat 125-108 në fushën e Bucksit. Edhe këtu, të gjithë titullarët e Indianas realizuan mbi 11 pikë, ku shkëlqeu Siakami me 37 pikë e 11 rebounde. Edhe pse Lillard realizoi 34 pikë për vendasit, këtë herë u ndje mungesa e Antetokounmpos.

ÇEREKFINALET - KONFERENCA E LINDJES

Cleveland - Orlando	(2-0)
New York - Philadelphia	(2-0)
Boston - Miami	(1-0)
Milwaukee - Indiana	108-125 (1-1)

ÇEREKFINALET - KONFERENCA E PERËNDIMIT

Minnesota - Phoenix	105-93 (2-0)
Denver - Lakers	(2-0)
Clippers - Dallas	93-96 (1-1)
Oklahoma - New Orleans	(1-0)

SHKURT

Mourinho: Për Romën refuzova Portugalinë dhe klubet arabe

Trajneri Jose Mourinho në një intervistë për "Telegraph" tregon se ka refuzuar oferta të rëndësishme për Romën. "Miqhtë e mi, familja ime dhe agjenti im më thanë të largohesha pas finales së Evropa Ligës vitin e kaluar, por ndjeva se duhej të rrija ende te ky klub. Gjithashtu refuzova oferta të rëndësishme si Arabia Saudite dhe kombëtarja e Portugalisë për të qëndruar te Roma", ka thënë Mourinho. "E ardhmja? Kam ende një karrierë të gjatë përpara, jam 61 vjeç, nuk mendoj se pensionohem në 65. Nuk është çështje klubi, e vetmja gjë që dua është që objektivat të përcaktohen nga të gjithë në kohën e duhur. Nuk mund të shkoj në një klub ku vetëm për shkak të historisë sime qëllimi të jetë të fitoj menjëherë një titull. Duhet kohë dhe investim në skuadër për ta bërë këtë", është shprehur "The Special One".

Allegri: E merituar kualifikimin në finale të Kupës

Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, ka thënë se "Zonja e Vjetër" e ka merituar kualifikimin në finalen e Kupës së Italisë. Juventusit pësoi humbje nga Lazio (2-1), por torinezët falë fitores në ndeshjen e parë u kualifikuan në finale.

"E dinim se do të ishte një ndeshje e vështirë. Skuadra luajti mirë në pjesën e dytë. Duke parë dy ndeshjet, ne e merituar finalen, edhe pse Lazio luajti një ndeshje të shkëlqyer", ka thënë Allegri.

Yamal shihet si pasues i Mbappes në PSG

Kylian Mbappe pritet të largohet nga Paris Saint-Germaini në afatin kalimtar të verës, derisa klubi francez është duke shprehur interesim për transferimin e talentit të Barcelonës, Lamine Yamal. Gazeta "Le Parisien" raporton se PSG-ja ëndërron transferimin e 16-vjeçarit mrekullibërës që po shkëlqen te Barcelona. Dominique Severac ka publikuar një shkrim ku thuhet se "për ta përforcuar vijën e sulmit sezonin e ardhshëm, i dobësuar nga largimi i Kylian Mbappes, klubi parisian dëshiron të nënshkruajë me lojtarin 16-vjeçar, i cili ka kontratë me Barcelonën deri në vitin 2026". Barcelona tashmë ka refuzuar një ofertë prej 200 milionëshe për xhevahirin e saj.

Dhimbje të forta në gjoks, Tevezi përfundon në spital

Ish-sulmuesi i Juventusit, Carlos Teves, tashmë trajner i Independiente de Avellaneda, ka përfunduar në spitalin e Buenos Aires gjatë natës pas problemeve shëndetësore. Mediet e huaja shkruajnë se shkak u bë një dhimbje në gjoks të cilën Tevez e kishte përjetuar edhe në tetor të vitit të shkuar kur ishte rrëzuar për tokë për shkak të gjendjes që kishte kaluar. Mbrëmjen e së martës, ish-sulmuesi argjentinas kërkoi ndihmë mjekësore dhe më pas u dërgua në një klinikë në Buenos Aires ku qëndroi gjatë natës. Testet mjekësore nuk kanë treguar për asgjë serioze deri më tani, ndërsa ish-futbollisti do të qëndrojë në spital për kontrollë të tjera të përgjithshme.

Ancelotti: Trajnerët italianë të futbollit janë më të mirët në botë

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, beson se trajnerët italianë janë më të mirët në botën e futbollit. Këtë e shprehu në një takim që pati me një grup studentësh, duke përfshirë edhe

dy ish-lojtarët e njohur, Alessandro del Piero dhe Ignazio Abate. Këta të fundit po kryejnë një kurs të përcaktuar nga FIGC për të drejtuar një skuadër në Serinë A dhe të marrin në fund një diplomë

master. Ky është proces ku përfshihen leksione dhe një teze përfundimtare, por edhe vizita në klube për ta studiuar metodologjinë e tyre. Ky grup tani po kalon dy ditë te Real Madridi ku

po merr udhëzime edhe nga Ancelotti i cili theksoi se trajnerët italianë janë më të mirët në botë. "Gjithmonë e mbaj mend shkollën e trajnerëve, sepse aty fillon të mësohet se çfarë do të thotë të jesh

trajner. Kujtoj shkëmbimin e ideve dhe pikëpamjeve që kishim mes shokëve të klasës. Më duhet të ritheksoj: trajnerët italianë janë më të mirët në botë", ka thënë Ancelotti.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:573/1
Datë: 24.04.2024

SHPALLJE KONKURSI

Për regjistrimin e kandidatëve të gjeneratës së katërt për nivelin e 5-të, të kualifikimit "Këshilltarë për Karierrë" në Qendrën e Kompetencës - Prizren

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e kandidatëve për regjistrimin e kandidatëve për nivelin 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), në Qendrën e Kompetencës në Prizren,

Të drejtë aplikimi kanë:

- 1.1 Kandidatët, Individë që punojnë në sektorin e arsimit dhe punesimit publik dhe privat (mësimdhënës, stafi i qendrave për karierrë, këshilltarët në zyre e punësimit, kompanitë e rekrutimit, ofruesit e trajnimeve);
- 1.2 Kandidatët të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë, shkollimin universitar (niveli 4 i kualifikimit ose më lartë).
- 1.3 Kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin, barasvlerësimin e diplomave dhe dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Ofrimi i kualifikimit

Baza e ofrimit të kualifikimit është Qendra e Kompetencës në Prizren si Institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)

3. Përfitimet për kandidatët

Të gjithë kandidatët të cilët me sukses e përfundojnë këtë kualifikim, do të pajisen me certifikatë të nivelit V për "Këshilltarë në karierrë" sipas standardeve të AKK

4. Kreditë

Kualifikimi për "Këshilltarë në karierrë" zgjat një 240 orë mësimore – gjashtë javë trajnimi, ku sipas KKK Kualifikimi Kombëtar Profesional (D) me 12 Kredi të Arsimit dhe Aftësimi Profesional.

5. Pagesa për kualifikim

Sigurimi i cilësisë së kualifikimit bëhet nga AKK dhe AAAPAR. Të gjithë kandidatët të cilët pranohen për këtë kualifikim janë të obliguar që në afat prej 3 ditëve para se të fillojnë ligjëratat, të paguajnë shumën prej 420 (katër qind e njëzet) Euro.

6. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Kandidatët për të konkuruar për regjistrim në kualifikimin e nivelit 5, "Këshilltarë në karierrë" duhet të paraqesin këto dokumente:

- ✓ Aplikacionin e cila merret Qendrën e Kompetencës Prizren;
- ✓ Kopja e letërnjoftimit
- ✓ Diplomën e shkollimit të mesëm të lartë,
- ✓ Diplomë tjetër të shkollimit universitar,
- ✓ CV
- ✓ I gjithë dokumentacioni duhet të prezantohet si kopje ndërsa origjinalet për verifikim i sjellin vetëm kandidatët të cilët do të pranohen.

7. Afati i paraqitjes së dokumenteve, vendi dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 29 prill 2024 deri 02 maj 2024

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Qendrën e Kompetencës Prizren, Lagjia Dardania pn, 20000 Prizren.

Lista e kandidatëve të pranuar shpallet më 08 maj 2024

Pagesat bëhet para se të filloj trajnimi me datë 13-14-15 maj 2024

Kthimi i dokumenteve për kandidatët, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet pas shpalljes së rezultateve.

Kandidatët e refuzuar në bazë të kriterëve për regjistrim kanë të drejtë që brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve të paraqesin ankesë në Qendrën e Kompetencës Prizren

8. Kriteret e regjistrimit

Përparësi kanë kandidatët, Individë që punojnë në sektorin e arsimit dhe punesimit publik dhe privat (mësimdhënës, stafi i qendrave për karierrë, këshilltarët në zyre e punësimit, kompanitë e rekrutimit, ofruesit e trajnimeve);

9. Kuotat për pranim të kandidatëve

Do të pranohen gjithsejt 15 kandidat për grup.

10. Fillimi i trajnimit

Pjesa e pare e trajnimit fillon 20 maj 2024- 31 maj 2024
Pjesa e dytë e trajnimit fillon 10 qershor 2024 – 21 qershor 2024
Pjesa e tretë e trajnimit fillon 01 korrik 2024 – 12 korrik 2024

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "GEO WIND" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812075572 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE


Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "GEO WIND" D.O.O. od Prishtine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812075572 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.


ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "GEO WIND" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812075572 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.


>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- | | |
|--|--|
| - Arben Morina shpall të pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren. | - Nexhmedin Tulla shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren. |
| - Enise Shuki shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Motrat Qiriaz" Prizren. | - Lavdije Sopi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Zef Lush Marku " Velezhe. |
| - Bejadin Dervishaj shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren. | - Zylmi Krasniqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q.K . "11 Marsi" Prizren. |
| - Jashar Krasniqi nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plot të shkollës fillore Kongresi i Manastirit Damjan KK Gjakovë. | - Edita Beqa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë. |
| - Astrit Tahiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Nexhmedin Nixha", Gjakovë. | - Xhavit Januzi nga Nivokazi KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. Bujqësi " Nexhmedin Nixha" Gjakovë. |
| - Alban Meta nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë prej klasës 1-8 të shkollës fillore "Selman Riza", Gjakovë. | - Fisnik Nixha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë, Elektroteknik. |
| - Fatlinda Gjuraj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm të mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë. | - Kingj Nikolla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. " Kadri Kusari" Gjakovë. |
| - Bekim Veljiji shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren. | - Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275 |





Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURISIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 03.04.2024, për vendin e punës:

I. Pozita: Auditor për Teknologji të Informacionit

Numri i referencës: ATI/ZKA/04-05/24

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 451 të datës 23.04.2024.

Prishtinë, 24.04.2024 Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU KONKURSA

Nacionalna kancelarija revizije obaveštava da se otkazuje konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a dana 03.04.2024. godine, za radno mesto:

I. Položaj: Revizor informacione tehnologije

Broj reference: ATI/ZKA/04-05/24

Konkurs se otkazuje na osnovu odluke br. 451 od datuma 23.04.2024.

Priština, 24.04.2024 Departman za upravljanje ljudskim resursima



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

100% Fresh & Natural



VIDAS
Llatte drink
2%



VIDAS
TAMËL
2,8%



VIDAS
Schmand
18% yndyrë
800g



VIDAS
JOGURT
100% Fresh & Natural



VIDAS
DHALLË
100% QUMESHTI I FERMEVE TONA



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

